



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 5 Mars 2022

Nr: 128

V E N D I M

P Ë R

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË BASHKISË SHKODËR, PËR DHËNIE AUTORIZIMI  
PËR NDRYSHIMIN E VENDNDODHJES SË DISA QENDRAVE TË VOTIMIT, PËR  
ZGJEDHJET E PJESSHME VENDORE TË DATËS 6 MARS 2022**

Në mbështetje të Dekretit nr. 13438, datë 20.01.2022, të Presidentit të Republikës, “Për caktimin e datës së zgjedhjeve të pjesshme vendore për kryetar bashkie për disa njësi të qeverisjes vendore”, nenit 19, pika 1, shkronja “n”, e 2, nenit 62, pika 4, nenit 93, pika 2 dhe 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V Ë R E N:

Neni 62, pika 4, e Kodit Zgjedhor përcakton se vendndodhja e qendrës së votimit caktohet në të njëjtën adresë me atë të zgjedhjeve të fundit, me përjashtim të rastit kur, për arsye objektive apo të parashikuara në nenin 93, kjo nuk është e mundur. Vendndodhja e qendrës së votimit nuk mund të ndryshojë në 40 ditët e fundit para datës së zgjedhjeve, përveç rasteve kur, për shkak të forcave madhore, ndryshimi autorizohet nga KQZ-ja.

Kryetari i Bashkisë Shkodër, me shkresën nr. 3658 prot., datë 04.03.2022, ka kërkuar dhënien e autorizimit për ndryshimin e vendndodhjes së 11 (njëmbëdhjetë) qendrave të votimit të njësive administrative Shalë Shosh dhe Pult, duke propozuar:

- QV-të 0116, 0117, 0119 dhe 0119/1, që ndodhen në njësinë administrative Shalë, fshati Breglumi, QV 0118 fshati Lekaj, të transferohen në të njëjtën NJA, fshati Theth, në shkollën publike 9-vjeçare;
- QV-të 0132 dhe 0133, që ndodhen në njësinë administrative Shosh, të transferohen në NJA Shalë, fshati Theth, godinë publike “zyrë informimi për turistët”;



- QV-të 0091, 0092, 0093 dhe 0094, që ndodhen në njësinë administrative Pult, të transferohen në njësinë administrative Postribë, fshati Prekal, godinë publike shkolla 9-vjeçare.

Në shkresën e dërguar referohet për kushte të vështira të këtyre qendrave të votimit duke përmendur kushtet atmosferike (zonë më ngricë dhe dëborë), mungesë e energjisë elektrike. Zhvendosja e tyre në vendndodhjet e kërkuara do të lehtësonte aksesin e zgjedhësve për të votuar dhe siguri për jetën e tyre, pasi terreni i vështirë shfaq rrezikshmëri.

Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor nr.2, pas njohjes me kërkesën e bashkisë Shkodër, shpreh dakordësinë për zhvendosjen e qendrave të votimit të NJA Shalë dhe Pult, dhe shpreh mosdakordësi për zhvendosjen e qendrave të votimit të NJA Shosh, duke refruar një zhvendosje të ndryshme nga ajo që propozon bashkia, konkretisht NJA Prekal, godinë publike “Shkolla 9-vjeçare”, ose të qendrojnë më vendndodhje aty ku janë aktualisht.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, nenin 62, pika 4, nenin 93, pikat 2 dhe 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 3, të udhëzimit nr.1, datë 05.12.2020, të Komisionit Rregullator, “Përcaktimi i rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjes së hartës së njësisë së vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet”,

### **V E N D O S I:**

1. Dhënien e autorizimit për ndryshimin e vendndodhjes së disa qendrave të votimit, sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Refuzimin e dhënies së autorizimit për ndryshimin e vendndodhjes së qendrave të votimit nr. 0132, 0133, 0091, 0092, 0093 dhe 0094, kërkuar nga Bashkia Shkodër.
3. Kryetari i Njësisë së Qeverisjes Vendore të kryejë menjëherë njoftimin me shkrim të zgjedhësve për vendndodhjen e re të qendrave të votimit, të caktuar me këtë vendim.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e tij, në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**



**Lidhja 1**

<b>Qarku</b>	<b>Bashkia</b>	<b>Nr.</b>	<b>Njësia Adm</b>	<b>QV</b>	<b>Vendndodhja e propozuar e QV</b>
<b>Shkoder</b>	<b>Shkoder</b>	1	Shalë	0116	NjA Shale, fshati Theth, Shkolla 9-vjecare
		2	Shalë	0117	NjA Shale, fshati Theth, Shkolla 9-vjecare
		3	Shalë	0118	NjA Shale, fshati Theth, Shkolla 9-vjecare
		4	Shalë	0119	NjA Shale, fshati Theth, Shkolla 9-vjecare
		5	Shalë	0119/1	NjA Shale, fshati Theth, Shkolla 9-vjecare